



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1516/ 6 prot.

Datë 04/09/2023

V E N D I M
Nr. 868/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/09/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-60975-03-01-2023, me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme*”, me fond limit 23.333.333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK me NIPT (K51501008J), me adresa: Lagjja Babrru Fushë, Paskuqan, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër.
Adresa: Bulevadi “Elez Isufi”, Peshkopi.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-60975-03-01-2023, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, me fond limit 23.333.333 (njëzet e tre milion e treqind e

tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibë.

II.2. Më datë 17.03.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor në shkresën nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023, protokolluar me shkresën tonë me nr. 1516/5 prot, datë 14.08.2023, rezulton se titullari i autoritetit kontraktor, ka marrë vendimin me shkresën nr. 2448 prot, datë 26.06.2023, për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 27.06.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar Njoftimi i Anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 03.07.2023, është publikuar në buletin Nr. 60, datë 03 Korrik 2023, Njoftimi i Anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi ku janë dhënë arsyet si më poshtë:

“[...] 7. Informacion shtesë

Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit përmbajnë mangësi të rëndësishme për zhvillimin e procedurës së prokurimit. [...]”

II.5. Në datën 01.07.2023 operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ka paraqitur formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3218, datë 01.07.2023 dhe me nr. 1516/2023 protokoll, datë 03.07.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor me përmbajtje si më poshtë vijon:

Ne datën 02.03.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve publike, me numer njoftimi CN/94115/03012023 procedura e prokurimit, E hapur, me mjete elektronike, numri i referencës së procedurës/Lotit: REF-60975-03-01-2023, objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, Kodi sipas Fjalorit të përbashkët të prokurimit (FPP): Pune ndertimi (45000000-7), Fondi limit: 23.333.333 (njetzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH. Ne datën 17.03.2023 ora 10-00 Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedure e prokurimit objekt ankimi. Ne kete procedure ne shoqeria Sireta 2F shpk, kemi marrje pjese, duke paraqitur oferten tone, per kete procedure tenderimi. Nga data 17.03.2023 deri ne date 27.06.2023, ne lidhje me procedure e mesiperme, nuk pati asnje vleresimi te ofertave te dorezuara ne sistemin e prokurimeve (SPE). I vetmi njoftim ka ardhur ne date 27.06.2023 ne te cilen njoftohemi se procedura objekt ankimi eshte anuluar per shkak se dokumentet e tenderit permbajne gabime ose mangesi te rendesishme. Operatori ynë ekonomik Sireta 2F ShPK, legjitimohet për paraqitjen e ankeses dhe ka respektuar afatin e paraqitjes së saj.

Sqarojmë se prima facie kemi interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohemi për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në Ligjin Nr.162/2020, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë. Konkretisht, në nenin 94, pika 1 të VKM 285, është parashikuar: cdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Duke qenë se njoftimi i anulimit të procedurës është publikuar në sistemin e prokurimeve publike në datë 27.06.2023, referuar nenit 110 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë, pika 2, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar në rastin e ankesave për vendimet e AK, operatorëve ekonomik i lind e drejta për të paraqitur ankesë brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të anulimit, pra e drejta për të paraqitur ankesë ka lindur në datë 27.06.2023. Në nenin 98 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë, neni 5 i tij parashikon seAutoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afatit të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji. Në kushtet sa sipër fillimi i afatit të ankimit, lidhet me publikimin e njoftimit të anulimit kjo bazuar dhe në nenin 38 të V.K.M Nr.258. Në bazë të parashikimit të nenit 110 rezulton se afati kohor për paraqitjen e ankesave për këtë procedurë është 27.06.2023 deri më 03.07.2023. Ankesa nga ana jonë po paraqitet duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës.

Së pari sqarojmë se gjatë përgatitjes së ofertës kemi pasur në konsideratë parashikimet ligjore, parimet e prokurimit publik dhe zbatimin në praktikë ku dhe KPP në vijimësi ka sqaruar se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që ti shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye operatori jonë ekonomik Sireta 2F ShPK në momentin e paraqitjes së ofertës ka analizuar të gjithë elementët e përbërës të dokumenteve të tenderit dhe ka paraqitur një ofertë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në vijim marrim në analizë ligjin për prokurimin publik dhe veprimet e kryera nga autoriteti kontraktor:

Se dyti: Referuar ligjit të ligjit të Prokurimit Publikë, është e parashikuar në nenin 98, pika 1/c, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 Per Prokurimin Publikë se: Autoriteti ose enti kontraktor anulon

një procedure prokurimi ne rastet kur: c) konstaton se dokumentet e tenderit permbajne gabime ose mangesi te rendesishme. Ne njoftimin marrjen e vendimit te anulimit te procedures neni 98 pika 5 citohet se.. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetem pas kalimit te afateve te ankimit sipas parashikimeve te nenit 110 te ketij ligji. Ne kushtet sa siper, ne nuk kemi nje vendim te publikuar nga autoriteti kontraktor, por vetem njoftim per anulimin e procedures. Ne e kundershtojme kete vendim per anulim procedure per shkaqet e meposhtme: Ne vendimin nr. Nr. 285, datë 19.5.2021, Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik, te Keshillit te Ministrave, percaktohen si me poshte: neni 73 Rolet dhe Përgjegjësitë në Autoritetin/Entin Kontraktor, neni 74, Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, nenin 75 Komisioni i Vleresimit te Ofertave, neni 76 Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, neni 77 Urdhri i Prokurimit, neni 78 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, neni 79 Dorëzimi i ofertave, neni 80 Hapja e ofertave, neni 81 Ndërhyrja në ofertë, Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave,

Ne kushtet sa siper, procedura objekt-ankimi eshte hedhur per t'u zhvilluar, nga Autoriteti Kontraktor ne date 17.03.2023. Gjate fazes se publikimit te procedures dhe hapjes se ofertes, me date 08.03.2023 eshte publikuar nje shtojce per ndryshimin e dokumenteve te tenderit si me poshte:

*Bazuar ne nenin , neni 75, pika 2, te LPP ,si dhe nenet 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave per Prokurimin Publik”, si dhe neni 23/ç te LPP, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave per Prokurimin Publik”, behet sqarimi dhe modifikimi per Operatoret Ekonomike te interesuar per proceduren e tenderit me objekt: **Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme** , Numri i referencës së procedurës/Lotit REF-60382-02-24-2023*

ISHTE: Shtojca 7, pika 2.2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës ose lotit që prokurohet.

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

BEHET: Shtojca 7, pika 2.2.2 Kapaciteti teknik

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

ISHTE: Shtojca 7, pika 2.3.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **40 (Dyzete) punonjës.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Nentor 2022 – e ne vazhdim.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Nentor 2022 – e ne vazhdim.**

Shenim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

BEHET : Shtojca 7, pika 2.3.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **38 (tridhjetë e tete) punonjës.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Nentor 2022 – e ne vazhdim.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Nentor 2022 – e ne vazhdim.**

Shenim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të

ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

ISHTE Shtojca 7, pika 2.3.4 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 1 (nje) inxhinier auditues/inspektues i sigurise rrugore i certifikuar sipas v.k.m. nr. 125 date 23.02.2011 “Per miratimin e strategjise kombetare te sigurise rrugore” dhe udhezimit nr.9 date 03.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore”, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, certifikaten perkatese si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 3 (tre) punonjes manovratore te, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 3 (tre) punonjes shofere te mjeteve te renda, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 2 (dy) teknik ndertimi, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per te pakten periudhën si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 1 (nje) saldator, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmi e aftesise profesionale, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 2 (dy) murator, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmi e aftesise profesionale, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit.*

Shenim: Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”,

“d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

BEHET Shtojca 7, pika 2.3.4 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshte:

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjes manovratore te, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), leshuar nga institucionet përkatëse, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjes shofera te mjeteve të rënda, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), leshuar nga institucionet përkatëse, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) teknik ndërtimi , për të cilin duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) saldator, për të cilin duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, dëshmi e aftësisë profesionale, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) murator, për të cilin duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, dëshmi e aftësisë profesionale, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.*

Shënim: Për këtë pikë 2.3.4 të mesipërme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

ISHTE Shtojca 7, pika 2.3.7 Kapaciteti teknik:

2.3.7 Operatoret ekonomik duhet te paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (shtojces 8):

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamionë vetëshkarkues kap. mbajtes mbi 8 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
2	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
3	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Rrul ngjeshes</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore</i>	<i>Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore</i>	<i>Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copel</i>
8	<i>Ekskavator me zinxhir</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Copel</i>
9	<i>Armature</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>200 m2</i>
10	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
11	<i>Asfalto-shtrues</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
12	<i>Ekskavator me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
13	<i>Makineri vijezimi</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
14	<i>Autovinç</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
15	<i>Fadrome me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
16	<i>Saldatriçe</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
17	<i>Gjenerator</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
18	<i>Vibrator</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>

Operatoret ekonomik qe disponojne kontrate furnizimi per Fabrike asfalti-betoni e pajisur dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kerkohet personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qira), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

- *Kokore, minimumi 40 copë.*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.*

- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.
- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- g) Mjeti autobitumatriçe te shoqerohet me Leje te Transportit te Mallrave te rrezikshme (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

BEHET Shtojca 7, pika 2.3.7 Kapaciteti teknik:

2.3.7 Operatoret ekonomik duhet te paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (shtojces 8):

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamionë vetëshkarkues kap. mbajtes mbi 8 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
2	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
3	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Rrul ngjeshes</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore</i>	<i>Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore</i>	<i>Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope1</i>
8	<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope1</i>
9	<i>Armature</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>200 m2</i>
10	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
11	<i>Asfalto-shtrues</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
12	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
13	<i>Makineri vijezimi</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
14	<i>Autovinç</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
15	<i>Fadrome me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
16	<i>Saldatriçe</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
17	<i>Gjenerator</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
18	<i>Vibrator</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
19	<i>Grejder</i>	<i>Ne pronesi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>

Operatorët ekonomik që disponojnë kontrate furnizimi për Fabrike asfalti-betoni e pajisur dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kërkojnë personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qira), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- *Kokore, minimumi 38 copë.*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.*

- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.*
- h)** *Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- i)** *Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- j)** *Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- k)** *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.*
- l)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- m)** *Makinat e transportit të shoqerohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
- n)** *Mjeti autobitumatriçe të shoqërohet me Leje të Transportit të Mallrave të rezikshme (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Ne kushtet sa sipër në Shoqëria Sireta 2F ShPK, në datën e hapjes së ofertave 17.03.2023 ora 10: 00, kemi paraqitur ofertën tonë, duke respektuar afatin, kriteret e përgjithshme dhe të vecanta, të percaktuar në D.S.T. Gjate perplimit dhe studimit të të gjitha dokumenteve të hedhuara në SPE, nga Autoriteti Kontraktor, në si shoqëri nuk kemi vërejtur apo konstatuar gabime ose mangësi të rëndësishme. Nga data 17.03.2023 deri me datë 27.06.2023, për këtë procedurë tenderimi nuk ka patur asnjë vendimmarrje. Në bazë të nenit 82 paragrafi 1, autoriteti

kontraktor, brenda 15 diteve nga data e hapjes se ofertes duhet te behet vleresimi i ofertes. Ne kushtet sa siper jane bere disa shkelje procedurale nga Autoriteti Kontraktor. Referuar nenit te mesiperm, autoriteti kontraktor, ne shkelje te ligjit ka shkelur afatin duke kaluar 3 muaj dhe pa bere asnje vleresim pa shkak ligjor sipas nesh. Ligji ka vendosur rezerve ligjore ne rastet kur ky afat nuk zbatohet dhe nuk jemi perpara ketyre rasteve. Shkelja e dyte: Ne nenin 75, pika 4 parashikohet. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në cdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Përgjithësisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë ti propozojë titullarit anulimin e procedurës. Ne kete rast kemi shkelje sepse nuk mund te konstatohet se ka kritere ne kundërshtim me legjislacionin pas 3 muajsh dhe per kete duhet te mbahet pergjegjesi administrative. Ne shoqeria Sireta 2F shpk, kemi paraqitur oferten tone, te cilen e kemi bazuar ne analizimin e te gjithë dokumentacionit te hedhur ne SPE. Nuk kemi konstatuar hartim apo mangesi ne kundërshtim me legjislacionin e prokurimit ose te fushes ne fuqi. Ne mendojme qe Autoriteti Kontraktor, duhet te vijojë me fazen e vlerësimit te ofertave dhe te bejë klasifikimin perkates sipas percaktimit ne dokumentet e tenderit. Vendimmarrja juaj ka sjelle pasoje per shoqerine tone. Per te marre pjese ne nje procedure tenderi, ne si kompani angazhojme kapacitet tona Teknike si, jurist, inxhinier, ekonomist etj, per analizimin, pergatitjen e dokumenteve per proceduren dhe paraqitjen e ofertes ne menyre dinjitoze. Plotesojme kushtin ligjor, qe eshte paraqitja e nje sigurimi oferte, e cila eshte nje shume e konsiderueshme. Ne keto kushte, vendimmarrja juaj, i ka shkaktuar shoqerise deme financiare. Kjo pasi angazhimi i punonjesve por dhe i eksperteve te jashtem, eshte sherbim i cili ofrohet me pagese si dhe pagesen e sigurimit te ofertes per procedure objekt-ankimi. Shoqeria jone ka qene korrekt me përmbushjen e kushteve dhe kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit. Me anulimin e procedures, nuk keni treguar korrektesi, barazi, profesionalizem dhe seriozitet ne punen tuaj, (konkretisht ne vendosjen e kriterëve, përpilimin e dokumenteve te tenderit si dhe vleresimi i drejte i ofertave).

Ne kushtet sa siper kerkojme:

1 -Pranimin e ankimit tone, si te bazuar ne ligj.

2 -Prishjen e vendimit te anulimit te tenderit, marre nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber per proceduren me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, me fond limit 23.333.333 (njetzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH, me NR. REF-60975-03-01-2023.

Vijimin e procedures se vlerësimit te ofertes te paraqitur ne date 17.03.2023, per proceduren e tenderimit me autoritet kontraktor Bashkia Diber, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme” me fondit limit 23.333.333 (njetzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH, me NR. REF-60975-03-01-2023.

Duke besuar ne nje vleresim te drejte nga ana juaj, mbetemi ne pritje te pergjigjes.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1516/2 prot., datë 04.07.2023 është publikuar pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Sireta 2F” SHPK për anulimin e vendimit të autoritetit kontraktor, për anulimin e procedurës së prokurimit, kundërshtuar me anë të ankesës me nr. 1516 protokoll, datë 03.07.2023.

II.7. Me qëllim shqyrtimin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, me anë të shkresës nr. 1516/3 prot., datë 04.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion si më poshtë:

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e

mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikim teknik, procesin e vlerësimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi së bashku me procesverbalet përkatëse si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1516/4 prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Kërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Agjencisë së Prokurimit Publik, duke kërkuar informacion dhe asistencë me përmbajtje si vijon:

Në datën 03.07.2023 është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesë nga një operator ekonomik në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-60975-03-01-2023, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, me fond limit 23.333.333 (njetzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër. Në lidhje me këtë procedure prokurimi nga verifikimi i kryer në SPE, rezulton se procedura e mësipërme nuk shfaqet në sistemin e prokurimeve elektronike në skedarin hetim.

Sa më sipër, bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkojmë nga ana juaj asistencë teknike për rikthimin e procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE, mbi vijueshmërinë e ndjekjes së hapave të mëtejshëm nga ana e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik për shqyrtimin e ankesës së sipërcituar.

II.9. Me shkresën nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023 me objekt: “Informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Sireta 2F SHPK” protokolluar me tonën me nr. 1516/5 prot, datë 14.08.2023 është dërguar nga ana e autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën e prokurimit, duke mos u shprehur në lidhje me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

“...Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1516/3 prot. të datës 04.08.2023 (protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2986 prot. datë 07.08.2023 ku kërkohet informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK Autoriteti Kontraktor Bashkia Dibër, po ju vë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. reference REF - 60975-03-01-2023 me objekt: Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme me fondit limit prej 23.333.333 (Njetzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 28.000.000 (Njetzet e tete milion) lekë me TVSH të vëna në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Dibër si më poshtë vijon:

1) Eshtë lëshuar urdhri prokurimit me nr. 120, date 23.02.2023, Urdhri ka parashikuar këtë përmbajtje:

a- Prokurimin e fondit limit 23.333.333 (Njezet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 28.000.000 (Njezet e tete milion) lekë me TVSH.

b- Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedure e Hapur”.

2) Nga ana e titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Diber, është lëshuar dhe urdhri “Për ngritje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave”, konkretisht urdhri me nr. 146, date 01.03.2023.

Pas lëshimit të urdhrit të prokurimit nga ana e Njesisë së Prokurimit është filluar puna, kjo bazuar në neni 74 te nr. VKM nr. 285, dt. 19.05.2021, i ndryshuar, i cili ka parashikuar shprehimisht detyrat e njesisë së prokurimit. Pas përgatitjes së Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) dhe miratimin e kësaj të fundit nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor, nga ana e Njesisë së prokurimit u be njoftimi i formularit të kontratës dhe u ngarkua procedura objekt prokurimi në sistemin elektronik të prokurimit, ku si referencë ky prokurim mban atë me nr. REF-60975-03-01-2023. Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me datë 01.03.2023 nga specialist i fushës në njësinë e prokurimit (inxhinieri) u bë hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik dhe hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese.

Në emailin e personit përgjegjës për prokurimin APP sjell asistencën për procedurën e prokurimit dhe rekomandimet për kriteret e kualifikimit. Pas marrjes së e-mailit titullari i autoritetit kontraktor lëshon urdhrin me nr. 166 date 08.03.2023 ku citohet: Të bëhet pezullimi i procedurës deri në modifikimin e kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit. Pas marrjes së urdhrit specialist i fushës në njësinë e prokurimit bën modifikimet në dokumentet e tenderit sipas shtojcës nr. 1 të datës 08.03.2023. Personi përgjegjës njofton titullarin e autoritetit kontraktor mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit. Titullari i autoritetit kontraktor nëpërmjet urdhrit nr. 167 date 08.03.2023 urdhëron heqjen nga pezullimi të procedurës dhe vazhdimin në normalitet të saj. Personi përgjegjës konstatoi mangësi në dokumentet e tenderit dhe menjëherë njoftoi titullarin e autoritetit nëpërmjet shkresës nr. 2503 prot te datës 15.06.2023 Titullari i autoritetit kontraktor doli në vendim për anulimin e procedurës në shkresën nr. 2448 prot të datës 26.06.2023. Njësia e prokurimit vazhdoi me anulimin e procedurës duke u bazuar pikën 1 germa c) të nenit 98 të ligjit nr. 162 date! 23.12.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme dhe në pikën 3 të nenit 98 te ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet: Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij nen.

Për shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik “Sireta 2F” SHPK autoriteti kontraktor nuk ka ngritur Komision të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) sepse duke u bazuar pikën 1 të nenin 114 të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” autoriteti kontraktor trajton ankesat e bëra për dokumentet e tenderit dhe ankesat për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave”.

Gjithashtu, bashkëlidhur informacionit të sipërcituar gjendet dhe shkresa nr. 2305 prot, datë 15.06.2023 e personit përgjegjës për prokurim, drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor me objekt “Informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme, me nr. Ref-60975-03-01-2023”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Për sa i përket procedurës së prokurimit me objekt Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme, me fond limit 23.333.333 pa TVSH, me nr. Ref-60975-03-01-2023.

Konstatohet mangësi në dokumente të tenderit (zërat e preventivit) si më poshtë:

- *AN3.104/b Germim dheu me ekskavator 0.5 m³, b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet (prishje e shtreses ekzistuese t=10 cm) = 741 m³*
- *An-9 Mbushje me zhavor në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri (seksionim +kasonete) = 228 m³*
- *3.158/1a Transport dheu me auto deri 1.0 km = 741 m³*
- *An.164/1a Shtresa me cakell e gur gurore, përhapur e ngjeshur me makineri në shtresa cdo 20 cm = 1,583 m³*
- *3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm = 7,912 m²*
- *3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm per bankine = 1,720 m²*
- *3.229/1 Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri = 6,192 m²*
- *3.231/1 Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri = 6,192 m²*

Shtojca 7 në pikën 2.3.7 Kapaciteti teknik të dokumentave të tenderit është kërkuar Kamiona vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton 2 copë për kryerjen me sukses të zërave të preventivit dhe të punimeve. Nga ana e specialistit të fushës anëtarë i njësisë së prokurimit është kërkuar kamiona vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton vetëm 2 copë gjë që çon në mos realizimin me sukses të procedurës pasi të gjitha pikat e lartë shënuara janë llogaritur që të realizohen për 3 javë në grafikun e punimeve. Këto mangësi në dokumentet e tenderit konstatohen nga ana ime si përgjegjës prokurimi, duke u bazuar në njohuritë minimale që kam përfituar për shkak të eksperiencës së punës në pozicionin aktual. Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, kërkoj anulimin e procedurës.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimes, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Sireta 2F” SHPK, mbi kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi me Nr. REF-60975-03-01-2023, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor në shkresën nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023, protokolluar me tonën me shkresën tonë me nr. 1516/5 prot, datë 14.08.2023, rezulton, se titullari autoritetit kontraktor ka marrë vendimin me shkresën nr. 2448 prot, datë 26.06.2023 për anulimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 27.06.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar Njoftimi i Anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Në datën 03.07.2023, është publikuar në buletin Nr. 60 datë 03 Korrik 2023 Njoftimi i Anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku janë dhënë arsyet si më poshtë:

“[...] 7. Informacion shtesë

Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit përmbajnë mangësi të rëndësishme për zhvillimin e procedurës së prokurimit. [...]”

III.1.3. Në datën 01.07.2023 operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ka paraqitur formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3218, datë 01.07.2023 dhe me nr. 1516/2023 protokollin, datë 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor me përmbajtje si më poshtë vijon:

III.1.4. Me shkresën nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023, me objekt: “*Informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Sireta 2F SHPK*” protokolluar me tonën me nr. 1516/5 prot, datë 14.08., është dërguar nga ana e autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën e prokurimit, duke mos u shprehur në lidhje me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Sireta 2F*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

“...Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1516/3 prot. të datës 04.08.2023 (protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2986 prot. datë 07.08.2023 ku kërkohet informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK Autoriteti Kontraktor Bashkia Dibër, po ju vë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. reference REF - 60975-03-01-2023 me objekt: Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme me fondit limit prej 23.333.333 (Njzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 28.000.000 (Njzet e tete milion) lekë me TVSH të vëna në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Dibër si më poshtë vijon:

1) Është lëshuar urdhri prokurimit me nr. 120, date 23.02.2023, Urdhri ka parashikuar këtë përmbajtje:

a- Prokurimin e fondit limit 23.333.333 (Njzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 28.000.000 (Njzet e tete milion) lekë me TVSH.

b- Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedure e Hapur”.

2) Nga ana e titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Diber, është lëshuar dhe urdhri për ngritje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave”, konkretisht urdhri me nr. 146, date 01.03.2023.

Pas lëshimit të urdhrin të prokurimit nga ana e Njësisë së Prokurimit është filluar puna, kjo bazuar në neni 74 te nr. VKM nr. 285, dt. 19.05.2021, i ndryshuar, i cili ka parashikuar shprehimisht detyrat e njësisë së prokurimit. Pas përgatitjes së Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) dhe miratimin e kësaj të fundit nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor, nga ana e Njësisë së prokurimit u be njoftimi i formularit të kontratës dhe u ngarkua procedura objekt prokurimi në sistemin elektronik të prokurimit, ku si referencë ky prokurim mban atë me nr. REF-60975-03-01-2023. Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me datë 01.03.2023 nga specialist i fushës në njësinë e prokurimit (inxhinieri) u bë hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik dhe hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese.

Në emailin e personit përgjegjës për prokurimin APP sjell asistencën për procedurën e prokurimit dhe rekomandimet për kriteret e kualifikimit. Pas marrjes së e-mailit titullari i autoritetit kontraktor leshon urdhrin me nr. 166 date 08.03.2023 ku citohet: Të bëhet pezullimi i procedurës deri në modifikimin e kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit. Pas marrjes së urdhrin specialist i fushës në njësinë e prokurimit bën modifikimet në dokumentet e tenderit sipas shtojcës nr. 1 të datës 08.03.2023. Personi përgjegjës njofton titullarin e autoritetit kontraktor mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit. Titullari i autoritetit kontraktor nëpërmjet urdhrin nr. 167 date 08.03.2023 urdhëron heqjen nga pezullimi të procedurës dhe vazhdimin në normalitet të saj. Personi përgjegjës konstatoi mangësi në dokumentet e tenderit dhe menjëherë njoftoi titullarin e autoritetit nëpërmjet shkresës nr. 2503 prot te dates 15.06.2023 Titullari i autoritetit kontraktor doli në vendim për anulimin e procedurës në shkresën nr. 2448 prot të datës 26.06.2023. Njësia e prokurimit vazhdoi me anulimin e procedurës duke u bazuar pikën 1 germa c) të nenit 98 të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme dhe në pikën 3 të nenit 98 te ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet: Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij nen.

Per shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik “Sireta 2F” SHPK autoriteti kontraktor nuk ka ngritur Komision të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) sepse duke u bazuar pikën 1 të nenin 114 të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” autoriteti kontraktor trajton ankesat e bëra për dokumentet e tenderit dhe ankesat për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave”.

Gjithashtu, bashkëlidhur informacionit të sipërcituar gjendet dhe shkresa nr. 2305 prot, datë 15.06.2023, e personit përgjegjës për prokurim, drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor me objekt “Informacion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt ‘Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme’”, me nr. Ref-60975-03-01-2023, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Për sa i përket procedurës së prokurimit me objekt Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme, me fond limit 23.333.333 pa TVSH, me nr. Ref-60975-03-01-2023.

Konstatohet mangësi në dokumente të tenderit (zërat e preventivit) si më poshtë:

- AN3.104/b Germim dheu me ekskavator $0.5\text{ m}^3, b > 2\text{ m}$, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet (prishje e shtreses ekzistuese $t=10\text{ cm}$) = 741 m^3
- An-9 Mbushje me zhavor ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (seksionim +kasonete) = 228 m^3

- 3.158/1a Transport dheu me auto deri 1.0 km = 741 m³
- An.164/1a Shtresa me cakell e gur gurore, perhapur e ngjeshur me makineri ne shtresa cdo 20 cm = 1,583 m³
- 3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm = 7,912 m²
- 3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm per bankine = 1,720 m²
- 3.229/1 Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri = 6,192 m²
- 3.231/1 Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri = 6,192 m²

Shtojca 7 në pikën 2.3.7 Kapaciteti teknik të dokumenteve të tenderit është kërkuar Kamionë vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton 2 copë për kryerjen me sukses të zërave të preventivit dhe të punimeve. Nga ana e specialistit të fushës anëtarë i njësisë së prokurimit është kërkuar kamioni vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton vetëm 2 copë gjë që çon në mos realizimin me sukses të procedurës pasi të gjitha pikat e lartë shënuara janë llogaritur që të realizohen për 3 javë në grafikun e punimeve. Këto mangësi në dokumentet e tenderit konstatohen nga ana ime si përgjegjës prokurimi, duke u bazuar në njohuritë minimale që kam përfutuar për shkak të eksperiencës së punës në pozicionin aktual. Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, kërkoj anulimin e procedurës.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
- d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.1.7. Në nenin 38 “Njoftimi i Anulimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

2. Njoftimi i anulimit duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- numrin e referencës së procedurës;
- objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;
- **arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.**

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.”

III.1.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sireta 2F” SHPK, i cili kërkon shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi si të pabazuar në ligj, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor në datën 26.06.2023 ka anuluar procedurën e prokurimit me arsyen se: *“Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit përmbajnë mangësi të rëndësishme për zhvillimin e procedurës së prokurimit”, gjithashtu në kthim përgjigjen e dërguar pranë KPP me shkresën nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1516/5 prot, datë 14.08.2023, autoriteti kontraktor ka dhënë këtë arsye anulimi: “[...] Personi përgjegjës konstatoi mangësi në dokumentet e tenderit dhe menjëherë njoftoi titullarin e autoritetit nëpërmjet shkresës nr. 2503 prot te dates 15.06.2023 Titullari i autoritetit kontraktor doli në vendim për anulimin e procedurës në shkresën nr. 2448 prot të datës 26.06.2023. Njësia e prokurimit vazhdoi me anulimin e procedurës duke u bazuar pikën 1 germa c) të nenit 98 të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku citohet “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Për sa i përket procedurës së prokurimit me objekt Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme, me fond limit 23.333.333 pa TVSH, me nr. Ref-60975-03-01-2023. Konstatohet mangësi në dokumente të tenderit (zërat e preventivit) si më poshtë:*

- AN3.104/b Germim dheu me ekskavator 0.5 m³, b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet (prishje e shtreses ekzistuese t=10 cm) = 741 m³
- An-9 Mbushje me zhavor ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (seksionim +kasonete) = 228 m³
- 3.158/1a Transport dheu me auto deri 1.0 km = 741 m³
- An.164/1a Shtresa me cakell e gur gurore, perhapur e ngjeshur me makineri ne shtresa cdo 20 cm = 1,583 m³
- 3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm = 7,912 m²
- 3.212/b Shtrese stabilizant 10 cm per bankine = 1,720 m²
- 3.229/1 Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri = 6,192 m²
- 3.231/1 Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri = 6,192 m²

Shtojca 7 në pikën 2.3.7 Kapaciteti teknik të dokumenteve të tenderit është kërkuar Kamionë vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton 2 copë për kryerjen me sukses të zërave të preventivit dhe të punimeve. Nga ana e specialistit të fushës anëtarë i njësisë së prokurimit është kërkuar kamioni vetëshkarkues kap. Mbajtës mbi 8 ton vetëm 2 copë gjë që çon në mos realizimin me sukses të procedurës pasi të gjitha pikat e lartë shënuara janë llogaritur që të realizohen për 3 javë në grafikon e punimeve. Këto mangësi në dokumentet e tenderit konstatohen nga ana ime si përgjegjës prokurimi, duke u bazuar në njohuritë minimale që kam përfituar për shkak të eksperiencës së punës në pozicionin aktual. Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, kërkoj anulimin e procedurës [...]”. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor Bashkia Dibër rezuton, se në kthim-përgjigje autoriteti kontraktor ka dhënë arsye tjetër anulimi nga ajo që ka

publikuar në njoftimin e anulimit të datës 26.06.2023, duke mos arritur të justifikojë ligjërisht anulimin e procedurës bazuar në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Për më tepër Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në kthim-përgjigje është shprehur, se personi përgjegjës për prokurimet ka konstatuar mangësi tek kriteri 2.3.7 i dokumenteve standarde të tenderit, në drejtim të sasisë së kamionëve të kërkuar me kapacitet mbajtës mbi 8 ton, pra kërkesa prej 2 kamionësh nuk është e mjaftueshme, nëse do të marrim në konsideratë volumin e punimeve dhe afatin kohor të përcaktuar në grafikun e punimeve, por nga ana tjetër pas verifikimeve të kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), në rubrikën raportet e auditimit rezulton, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e procedurës, duke hapur dhe ofertat e pjesëmarrësve dhe akoma më tej për njërin nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka pasqyruar në raport audit edhe arsyen e skualifikimit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor Bashkia Dibër nuk ka arritur të argumentojë, se si këto konstatime nga ana e zyrtarit përgjegjës për prokurim dhe jo nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili në ato momente kishte hapur ofertat e pjesëmarrësve në procedurë, pra pasi janë hapur ofertat, kanë çuar drejt anulimit të procedurës së prokurimit, kanë ndikuar në procesin e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë dhe vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor referuar Njoftimit të Anulimit, si dhe shkresës me nr. 2986/1 prot, datë 09.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1516/5 prot, datë 14.08.2023 ka dhënë dy arsye të ndryshme për anulimin e procedurës, si dhe nuk ka arritur të argumentojë ligjërisht se përse e ka anuluar këtë procedurë prokurimi. Për më tepër autoriteti kontraktor është në shkelje, pasi ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës, pra me hapjen e ofertave, dhe akoma më tej njëri nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka pasqyruar arsyen e skualifikimit në raport audit për njërin nga pjesëmarrësit në këtë procedurë prokurimi. Ndodhur në këto kushte, KPP, gjykon, se anulimi i procedurës së prokurimit, nuk është bërë në përputhje me nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, për këtë arsye autoriteti kontraktor të rikthejë procedurën e prokurimit në fazën e vlerësimit. Vendimi i titullarit të autoritetit kontraktor i datës 26.06.2023 mbi anulimin e procedurës së prokurimit dhe publikimin e aktit administrativ të njoftim-anulimit të procedurës më datë 27.06.2023, është akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) “si çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se akti administrativ i titullarit të autoritetit kontraktor i datës 26.06.2023, në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, pasi është vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra hapjen e ofertave, do të konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm, pasi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në këtë fazë ka vijuar me hapjen e ofertave dhe madje dhe me vlersimin e njërit prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës referuar raportit të auditit në të cilin konstatohet arsyeja e skualifikimit. Anulimi i

procedurës së prokurimit me propozim të personit përgjegjës për prokurim në këtë fazë, e bën atë absolutisht të pavlefshëm si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (*quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest*). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konstaton se akti administrativ i titullarit të autoritetit kontraktor i datës 26.06.2023 në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi është akt-administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.”, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në gjendjen e vlerësimit të ofertave, duke vijuar me procesin në përputhje me parashikimet ligjore. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmyjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisiprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të

*gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”. Sa më sipër, KPP konstaton, se vendimi i titullarit të autoritetit kontraktor i datës 26.06.2023 mbi anulimin e procedurës objekt-shqyrtimi, si një akt administrativ individual, i shtrin efektet *inter parties*, jo vetëm mbi ankimuesin, por dhe mbi pjesëmarrësit dhe në asnjë rast *erga omnes*. Ndaj KPP, gjykon, se ky vendim është në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj duhet të anulohet si vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.*

Sa më sipër, KPP gjykon, se anulimi i procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen anulimin e procedurës, në këtë fazë procedurale të pajustificuar, të paargumentuar dhe të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

II.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis*, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale të pajustificuara dhe të paargumentuara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-60975-03-01-2023, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, me fond limit 23.333.333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-60975-03-01-2023, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtarë e Poshtme”, me fond limit 23.333.333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër, dhe ta rikthejë atë në momentin procedural të vlerësimit të ofertave.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

